

Komuna e Istogut: **problemet kryesore dhe trendët buxhetor**

Hyrje

1. Komuna Istogut mbulon një sipërfaqe prej 454 km² dhe përfshin qytezën e Istogut dhe 50 fshatra. Istogu ka 39.289 banorë.¹
2. Komuna e Istogut udhëhiqet nga Kryetari Haki Rugova nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Rugova e ushtron funksionon e Kryetarit të Komunës nga muaji maj i vitit 2010, apo pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme pas vdekjes në detyrë të kryetarit Fadil Ferati. Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Komunën e Istogut janë zhvilluar në dy raunde. Haki Rugova kishte siguruar fitoren pas zgjedhjeve në balotazh mes tij dhe Shasivar Haxhiaj nga PDK.
3. Ekzekutivi i Komunës së Istogut përbëhet nga tetë drejtori. Nga 27 asambleistë sa numëron në tërësi Kuvendi Komunal i Istogut, 11 prej tyre janë nga LDK. LDK është në koalicion me LDD, i cili subjekt politik ka tre përfaqësues në Kuvendin Komunal. Subjektet tjera politike të përfaqësuara në Kuvendin Komunal janë PDK me pesë asambleistë, AAK me gjashtë, AKR me një dhe IRDK (Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës) me një përfaqësues.
4. Një përqindje mjaft e lartë (74%) e banorëve të Istogut besojnë se autoritetet e tyre lokale kanë kapacitet për të zgjidhur problemet në komunën e tyre, kurse 11% (në krahasim me mesataren e kosovarëve 15%) besojnë se vetëm pushteti qendror mund të zgjidhë këto probleme.²
5. Në hulumtimin e kryer nga Instituti GAP në fund të vitit 2009, problemet kryesore në këtë komunë kanë qenë mungesa e ujit të pijes, prezenca e ujërave të zeza në shumë vendbanime, prezenca e theksuar e mbeturinave, prerja e pyjeve, mungesa e hapësirave

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2012. Fq 134. Burimi: http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

² Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

të gjelbëruara dhe mungesa e zyrave lokale për ofrimin e shërbimeve administrative qytetarëve.³

Problemet kryesore të Komunës së Istogut

- 1. Mungesa e sistemit të ujësjellësit dhe ujit të pijes në disa fshatra.** Istogu konsiderohet të ketë burime të shumta të ujit të pijes. Kjo dëshmohet edhe përmes planifikimeve të Komunës së Klinës e cila synon që problemin e mungesës së ujit të pijes ta zgjidh përmes burimeve të Istogut. Por, përkundër kësaj, disa lokalitete në këtë komunë aktualisht nuk janë të lidhura në sistemin e ujësjellësit publik. Kësisoj janë fshatrat Suhogërrllë dhe Prekallë. Në disa fshatra të tjera ekzistojnë ndërprerje të gjata të ujit të pijes, ku ndërprerjet zgjasin me muaj. Këto fshatra janë Rakosh, Shushicë, Uqë, Zhakovë dhe Veriq. Një specifikë në këtë komunë paraqet fshati Zallq i cili edhe pse e ka të rregulluar sistemin e ujësjellësit, tash e 10 vite është pa ujë të pijes.⁴ Hulumtimi i UNDP-së tregon se 71% e familjeve të lidhura me ujësjellësin publik nuk kanë deklaruar që kanë ndërprerje të ujit të pijes, 6% kanë deklaruar që kanë ndërprerje nga 1 deri në 4 orë në ditë dhe 6% kanë deklaruar se reduktimet e ujit në vendbanimet e tyre shkojnë gjatë një dite 5 deri në 10 orë.⁵
- 2. Derdhja e kanalizimit në “Lumbardh”.** Të gjitha kanalizimet derdhen në shtratin e lumit që përshkon pjesën më të madhe të brendisë së qytetit të Istogut. Në disa pjesë rrjedha e lumit kundërmon, shkaku i derdhjes së kanalizimeve. Qyteti i Istogut nuk i ka të ndarë gypat e ujërave të zeza prej gypave të ujërave atmosferikë. Komuna e Istogut ka qenë ndër komunat e para në Kosovë që para viteve '90-ta ka pasur impiant për trajtimin e ujërave të zeza të vendosura në Banjicë. Asnjëri nga këta dy impiantë nuk është funksional që nga 1999. Në hulumtimin e zhvilluar nga organizata DEMI/USAID, 55% e banorëve të kësaj ane janë shprehur të pakënaqur me gjendjen e kanalizimeve në vendbanimet apo në qytetin e tyre.⁶

³ Instituti GAP. Raporti komunal. Komuna e Istogut. 2009. Fq 3. Burimi:

http://www.institutigap.org/documents/40809_Istogu-raporti%20komunal.pdf

⁴ Agjencia e Lajmeve “Indeksonline”. 10 Gusht 2013. Burimi:

<http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=67312>

⁵ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 60. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

⁶ Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 23. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

- 3. Prerja e pyjeve.** Pyjet e rajonit të Istogut prehen vazhdimisht. Nga prerja ilegale e pyjeve nuk kursehen as zonat të cilat konsiderohen si atraksion natyror të kësaj komune si “Lugu i Zymit”. Rajonet më të prekura nga ky fenomen janë Lugë i Zymit, Mokna, Radusha, Lugu i Butë.
- 4. Mos zhvillimi i turizmit.** Komuna e Istogut është e njohur edhe për resurset e mira që ka në zhvillimin e turizmit malor. Me përjashtim të rregullimit të rrugëve, komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë hap tjetër në sensibilizimin dhe forcimin e sektorit të turizmit. Istogu është i njohur edhe si vend me trashëgimi kulturore ku përafërsisht janë të evidentuara rreth 28 vendndodhje arkeologjike (si në Studenicë, Vrellë, Bojnicë dhe Surriganë) dhe ka rreth 72 kulla të evidentuara.⁷
- 5. Mbeturinat.** Prezenca e deponive të egra është problem për qytetarët e Istogut. Deponitë e mbeturinave gjenden në fshatrat Llukac i Begut, Rakosh, Dubravë, Lubozhd etj. Sipas raportit të UNDP-së, 14 % e banorëve e konsiderojnë qytetin e tyre të fëlliqur ose shumë të fëlliqur, ndërsa 31% e konsiderojnë të fëlliqur lagjen e tyre.⁸

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur

- 1. Ruajtja e resurseve natyrore.** Komuna e Istogut është e njohur për bukuritë e saja natyrore sidomos Bjeshkët e Istogut, andaj ruajtja dhe investimi në to është më se i nevojshëm.
- 2. Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe vendndodhjeve arkeologjike.** Janë rreth 28 vendndodhje arkeologjike (si në Studenicë, Vrellë, Bojnicë dhe Surriganë) dhe janë të evidentuara rreth 72 kulla në Komunë të Istogut. Bashkëbiseduesit kanë kërkuar që këto vende të promovohen dhe të investohet në kushtet e përgjithshme me qëllim të tërheqjes së vizitorëve.


⁷ Enver Buletini. Përgjegjes i muzeut etnologjik në Komunë të Istogut.

⁸ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Burimi:<http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo Mosaic 2012 Alb 216 825.pdf>

Trendet Buxhetore në Komunën e Istogut

Komuna e Istogut në vitin 2013 ka planifikuar 8.4 milion euro buxhet. Krahasuar me vitin 2010, buxheti i kësaj komune është rritur për 1.7 milion euro (25%). Të hyrat vetanake të kësaj komunë në vitin 2012 kanë qenë 765 mijë euro, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kanë rënë për 44 mijë euro (5%). Zyra e Auditorit të Përgjithshëm⁹ ka gjetur se borxhet e grumbulluara nga tatimi në pronë janë 776 mijë euro. Numri i pronave të regjistruara në vitin 2013 ka qenë 9.8 mijë ndërsa sipas Komunës së Istogut rreth 6.8 mijë (70%) e tyre janë pagues të rregullt kurse 450 janë të paregjistruara.¹⁰

Figura 1. Buxheti i Komunës së Istogut 2013




⁹ ZAP, Raporti i Auditimit mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Istogut Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 06 Gusht 2013 http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KIS_2012_Shqip_44284.pdf

¹⁰ Komuna e Istogut, Përgjigje në Kërkesën e Institutit GAP, 06 Shtator 2013

Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?istog/2013#/~/istog>

Në bazë të grafikonit rreth ndarjeve buxhetore shohim se investimet kapitale kanë pasur një trend të rënies në vitet 2010-2012, ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime në vitin 2012 kanë shënuar ngritje prej 416 mijë euro (69%).

Figura 2. Trendet e Ndarjeve Buxhetore 2010-2013



Në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2014-2016 shohim se Komuna e Istogut planifikon një rritje të lehtë të buxhetit. Kjo rritje është planifikuar të ndodh për shkak të rritjes së grantit qeveritar dhe të hyrave vetanake.

Tabela 1. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve 2014-2016

	2014	2015	2016
Të hyrat totale	7,789,708	7,901,572	7,907,672
Të hyrat vetanake	945,000	945,850	951,950
Granti i Pergjithshëm	2,956,691	2,898,394	2,898,394
Granti Specifik për Arsimin	3,018,575	3,182,803	3,182,803
Granti Specifik për Shëndetësinë	869,442	874,524	874,524

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulomtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulomtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Istogut është bërë përmes hulomtimit në terren nga ana e zyrtarëve të GAP, intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP dhe BIRN janë krahasuar edhe me të dhënat e hulomtimit më të mëdha që janë bërë viteve të fundit në nivel lokal, ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012), etj.



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.